VENDIM
Nr. 322, datë 27.4.2016

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 669, DATË 7.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR PËRCAKTIMIN, KRIJIMIN DHE REALIZIMIN E KORNIZËS REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH-2010), SI METADATË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1 e 4, të nenit 13, të ligjit nr. 72/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e infra-strukturës kombëtare të informacionit gjeohapë-sinor në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Adminis-tratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 669, datë 7.8.2013, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në titull dhe kudo në tekstin e vendimit e të rregullave bashkëlidhur tij, emërtimi "KRGJSH-2010" zëvendësohet me "KRGJSH".

2. Në pikën 2, emërtimi "Ministri për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit" zëvendësohet me "Ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike".

3. Në tekstin e rregullave bashkëlidhur këtij vendimi bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në nenin 2 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Në paragrafin e dytë, të pikës 3, fjalët "... "Epoka 2010", lidhet me kohën (1 janar 2010), në të cilën duhet të llogariten koordinatat e rrjetit shtetëror GPS...", hiqen.

ii) Pas pikës 7 shtohet pika 7/1, me këtë përmbajtje:

"7/1. CORS (Continuously Operating Reference Stations) është rrjeti i stacioneve referencë të operimit të vazhdueshëm për përcaktimin e pozicionimit tredimensional në sipërfaqen e tokës, nëpërmjet sistemeve GNSS.".

b) Në nenin 3 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

i) Pika 1 riformulohet, si më poshtë vijon:

"1. Korniza Referuese Gjeodezike që do të përdoret në Republikën e Shqipërisë do të quhet "Korniza Referuese Gjeodezike Shqiptare" ose shkurt (KRGJSH).".

ii) Pas pikës 4 shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:

"5. Përzgjedhja e realizimit të referencës evropiane dhe përcaktimi i epokës do të bëhen me vendim të ASIG-ut.".

c) Neni 8 riformulohet si më poshtë vijon:

"Neni 8

Rrjeti shtetëror GPS materializohet nëpërmjet ndërtimit të rrjetit shtetëror aktiv të stacioneve CORS dhe rrjetit shtetëror pasiv. Koordinatat e pikave të këtyre rrjeteve përcaktohen sipas KRGJSH-së.".

ç) Pas nenit 8 shtohen nenet 8/1 e 8/2, me këtë përmbajtje:

"Neni 8/1

Stacionet bazë të rrjetit shtetëror aktiv CORS dhe pikat e rrjetit shtetëror pasiv të vendosen në territore të institucioneve shtetërore qendrore, vendore apo shkencore, të cilat duhet të garantojnë ruajtjen fizike të rrjeteve dhe funksionimin e pandërprerë me energji të stacioneve CORS. ASIG-u garanton përdorimin e të dhënave të rrjetit aktiv nga institucionet, për qëllime të veprimtarisë së tyre.

Neni 8/2

Stacionet mareografike të rrjetit shtetëror të KRGJSH-së materializohen në terren si bazë për përcaktimin e nivelit mesatar të detit. Stacionet mareografike ndërtohen në territore të reparteve

ushtarake dhe Ministria e Mbrojtjes duhet të garantojë ruajtjen fizike dhe funksionimin e pandërprerë me energji të tyre.".

d) Neni 9 riformulohet si më poshtë vijon:

"Neni 9

Radha e kryerjes së punimeve, përgatitja e instruksioneve me kërkesat teknike për projektimin, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të parashikuara në nenin 5, përfshi këtu rrjetin shtetëror pasiv dhe rrjetin aktiv të stacioneve CORS, përcaktohen dhe miratohen nga ministri përgjegjës për infrastrukturën kombëtare të informacionit gjeohapësinor me propozimin e ASIG-ut.".

dh) Në nenet 10 dhe 11 hiqet përcaktimi "2010".

e) Shkronja "c" e shtesës I të vendimit riformulohet, si më poshtë vijon:

"c) Faktori dinamik i figurës së tokës pa përfshirë baticën e qëndrueshme: J2=108 263x10^{-8};

Këtij faktori i korrespondon shtypja në pole: 1/f = 298.257 222 101;".

ë) Paragrafi në fund të shtesës II të vendimit riformulohet, si më poshtë vijon:

"Ndarja dhe emërtesat e fletëve të hartave për shkallë më të mëdha se shkalla 1:2500 përcaktohet me vendim të ASIG-ut.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama